

URDHËR
Nr. 253, datë 23.10.2020

**PËR SHPALLJEN E NDRYSHIMEVE TË STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË
KONTABILITETIT NR. 1 “PARAQITJA E PASQYRAVE FINANCIARE”**

Në mbështetje të nenit 3, pika 4, të ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 1 “Paraqitja e pasqyrave financiare” (SNK 1).
2. Ndryshimet e SNK 1, të publikuara në vitin 2020, kanë datë efektive 1 janar 2023. Lejohet zbatimi përpara datës efektive, por njësi ekonomike duhet të japë shënime shpjeguese për këtë fakt.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

Ndryshime në SNK 1 “Paraqitja e pasqyrave financiare”

Paragrafi 139U ka ndryshuar. Teksti i fshirë është bërë me vizë në mes dhe teksti i ri është nënvizuar.

Periudha kalimtare dhe data e hyrjes në fuqi

...

139U *Klasifikimi i detyrimeve, si afatshkurtër ose afatgjatë*, i publikuar në janar 2020, ndryshoi paragrafët 69, 73, 74 dhe 76, si dhe shtoi paragrafët 72A, 75A, 76A dhe 76B. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore raportuese që fillojnë në datën 1 janar ~~2022~~2023 ose pas kësaj date, në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.